



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 16, datë 09.04.2020

PËR

KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NDAJ BIZNESIT DHE SHTYRJEN E AFATIT TË PAGESËS SË QIRASË PËR BANESAT SOCIALE NË KUADËR TË MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-19

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Aktit normativ nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar, Aktit normativ nr.4, datë 16.03.2020 “Për masat administrative për mosrespektimin e kufizimeve nga individët”, Urdhërit nr.132, datë 08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, Urdhërit Nr.156, datë 10.03.2020 ”Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, Urdhërit nr. 193, datë 20.03.2020 të Ministrise së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për kufizimin apo mbylljen e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB nr. 569, datë 20.12.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, i ndryshuar dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z. Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të pagesës së tarifave vendore nga data 20 Prill 2020, për në datën 30 Qershor 2020 për të gjitha aktivitetet e mbyllura në zbatim të Urdhërit nr.193,

datë 20.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për kufizimin apo mbylljen e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Miratimin e shtyrjes së detyrimit të qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020 për të gjithë qiramarrësit individë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesat sociale me palë qiradhënës Bashkia Durrës. Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, në mënyrë proporcionale për periudhën e mbetur të vitit 2020
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike të Bashkisë Durrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 09.04.2020